



Planuar / Dorezuar Primiçeno/Prodato Received/Delivety	04.10	2023	3	viti, gusht viti
Organ /Njesia Organ /Jednica Orgj /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKANSHKIC	6388/2023		1/2	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.1183/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti -kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arditë Haxhnikaj Demi-anëtar, me Vjollca Sinani-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1183/2023 të datës 19.09.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted] kundër organit të punësimit ,Ministria e Punëve të Brendshme /Departamenti për Siguri Publike, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1,nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.10.2023 mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i inicuar sipas ankesës me numër A.nr.1183/2023 të datës 19.09.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesi, [redacted] me datë 19.09.2023 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 6152/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me koeficientin e pagës, cenim të dispozitave esenciale të procedurës administrative dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale.

Në proces të shqyrtimit të ankesës nga këshilli ankuesi më datë 03.10.2023 përmes shkresës me numër protokolli 6367/2023, ka tërhequr ankesën A.nr.1183/2023 të datës 19.09.2023, me arsyetimin se më datë 29.09.2023 ka pranuar përgjigjeje nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik.

Andaj, Kolegji i Këshillit pas pranimit të kërkesës së ankuesit për tërheqje nga ankesa, e duke u bazuar në nenin 103 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të



cilin është përcaktuar se: "1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë", vendosi që të përfundoj procedurën administrative të inicuar sipas ankesës me numër A.nr.1183/2023 të datës 19.09.2023.

Në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit është i paligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1183/2023, datë 04/10/2023.

Vjollca SINANI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit ,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

